



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPSTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e –VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
14 shtator 2018 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 14:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova Melihate Basholli-Latifi, Nezir Klinaku dhe Lutfi Bilalli (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Fjolla Ujkani.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Adnan Lahu, Berat Sadiku), Ismet Gashi, nga zyra ligjore, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se nuk po respektohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës nga ana e qeverisë komunale, sepse nuk po i sjellin pikat që janë të parapara me këtë plan. Njëra nga këto pika është Draft-rregullorja e tatimit në pronë, e cila nuk ka ardhur. Ai pyeti se deri në mbledhjen e kuvendit, a mund të vijë kjo draft-rregullore? Po ashtu, ai pyeti se Informata për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2018/2019 a do të vjen deri në mbledhjen e kuvendit? E kemi një arsyetim nga Drejtoria për Arsim, e cila ka kërkuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, për shkak të sistemit online SIMA. Po ashtu kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës: “Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e masës drusore të konfiskuar-institucioneve arsimore të komunës sonë”, pasi që është e jashtëligjshme. Pse kryetari i komunës me vendim të tij nuk po ia dhuron këto dru shkollave, por po e sjell në kuvend. Nëse votohet ky propozim në këtë formë, personalisht do ta ndjek çdo mjet ligjor.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së**- tha se lidhur me Propozim-vendimin për shpërndarjen e masës drusore të konfiskuar-institucioneve arsimore të komunës sonë, personalisht i kam shfaqur shqetësimet e mia. Ai tha se ka kërkuar që ta shikojë zyra ligjore këtë propozim-vendim.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – lidhur me Draft-rregulloren e tatimit në pronë, e cila nuk është proceduar deri më tani në kuvend, ai sqaroi se që nga 1 tetori 2018 hyn në fuqi Ligji i ri për tatimin në pronë dhe në përputhje me këtë ligj do ta harmonizojmë edhe draftin e rregullores dhe në muajin nëntor do ta procedojmë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – lidhur me informatën nga Drejtoria për Arsim që nuk është proceduar theksoi se nëse e përgatisin deri në ditën e seancës së kuvendit, atëherë do ta fusim si

pikë në të ndryshme. Lidhur me propozim-vendimin për shpërndarjen e masës drusore të konfiskuar-institucioneve arsimore të komunës sonë që u kërkua të hiqet nga rendi i ditës, ai tha se nuk kemi nevojë ta heqim nga rendi i ditës, ngase nëse një vendim i tillë është i kundërligjshëm, atëherë MAPL-ja mund ta kthejë konfirmimin e ligjshmërisë së vendimi në fjalë është i kundërligjshëm.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se ekziston legjislacioni për mënyrën e dhënies së druve, pra shiten përmes ankandit publik. Lidhur me këtë ai kërkoi sqarime nga zyra ligjore.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se nëse i shesim përmes ankandit publik drutë, duhet t'iu jepen atyre që ofrojnë çmimin më të lartë, gjë që p.sh. mund të jetë 30 euro për m<sup>2</sup>, kurse me tender e kemi çmimin 42 për m<sup>2</sup> që e kemi blerë. Në ankand publik nuk mund të përcaktojmë çmim, siç e kemi pasur rastin me ankandin publik për shitjen e materialit ndërtimor të objektit të komunës së vjetër dhe askush nuk ka shprehur interesim për të blerë. Ky propozim bazohet në Ligjin për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësisë, ku thuhet se: komuna me asetet e saj ka të drejtë të disponojë, t'i shesë, dhurojë, tjetërsojë në forma të ndryshme etj. Nëse është vendim i kundërligjshëm, atëherë MAPL-ja na e kthen përgjigjen se vendimi në fjalë është i kundërligjshëm.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se në ankand publik mund të vendoset çmimi minimal. Ai pyeti kryetarin e komunës se pse nuk po i jep vet, por po kërkon që kuvendi të merr vendim?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – u shpreh se kjo është pasuri e komunës dhe po dua që t'ia lë “nerën” kuvendit.

**Ismet Gashi, zyrtar i zyrës ligjore** – tha se tek rasti i shitjes së lëndës drusore, ekziston Udhëzimi Administrativ nr. 06/2010, ku paragrafi 5 thotë që: “Ankandet-tenderët për shitjen e lëndës drusore të konfiskuar e të deponuar në ruajtje të përkohshme, realizohen gjatë vitit kalendarik”. Unë atë që e shoh kontestuese është se drejtoria përkatëse është dashur të na sqarojë se lidhur me lëndët e konfiskuara (drutë), a ka ndonjë proces gjyqësor që është duke u zhvilluar? Nëse nuk kemi proces gjyqësor, atëherë atë që e tha kryetari në bazë të ligjit dhe rregulloreve për pasurinë jofinanciare, për t'i falur ekziston mundësia me vendim të kuvendit, kurse për t'i shitur pa ankand nuk kemi të drejtë.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** – tha se zyra ligjore t'i drejtohet me një shkresë MAPL-së dhe të kërkojë konsultim paraprak që deri në mbledhjen e kuvendit të na kthejnë përgjigje se e a kemi të drejtë t'i falim drutë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – pyeti se a ka pasur praktika të tilla nga qeverisja e kaluar? Ne po e dimë që kjo është e kundërligjshme dhe nuk kemi nevojë të votojmë diçka që është e kundërligjshme. Nëse ka pasur raste të tilla në të kaluarën të na tregoni se a është e ligjshme apo jo.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se ish-kryetari i komunës, Bajram Mulaku ua ka shpërndarë shkollave drutë, mirëpo ka qenë në gjykatë dhe është akuzuar për vepër penale.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** – tha se gjatë periudhës sa kam qenë drejtor në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i kam shpërndarë drutë vetë, kurse,

më vonë ka filluar çështja të merret më serioze, ku pasi që unë kam shkuar në detyrën e re, kryetari i komunës z. Bajram Mulaku i ka shpërndarë edhe 2 apo 3 herë drutë, tha Aliu, i cili shtoi se qysh e tha Neziri është akuzuar për vepër penale për një gjë të tillë.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – tha se le të kalojë ky propozim në këtë mënyrë, por paraprakisht le të merret zyra ligjore me këtë çështje para se të vjen në kuvend.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se iu kemi drejtuar me shkresë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), mirëpo nuk na kanë kthyer përgjigje, gjë që e kanë obligim ligjor për të kthyer përgjigje.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – tha se është mirë që zyra ligjore të na jep një opinion deri në mbledhjen e kuvendit. Prandaj, po e shohim që qëllimi është për interes të përgjithshëm dhe mund të votohet në kuvend. Lidhur me Draft-rregulloren e tatimit në pronë, tha se nga praktikat e kaluara, kjo rregullore duhet të shkojë paralel me buxhetin. Pra, si draft është dashur të vjen në mënyrë që të kemi kohë t'i shfrytëzojmë procedurat, sepse pas miratimit në shqyrtim të parë duhet të shkojë në diskutim publik. Tutje tha se në të kaluarën, e kemi mbajtur çdoherë një takim të veçantë të KPF-së vetëm për shqyrtim të buxhetit, kësaj radhe nuk ka ndodhur, madje edhe draft-buxheti ka ardhur sot kur po mbahet takimi, gjë që nuk është praktikë e mirë kjo. Kryesuesi i kuvendit është dashur ta ftojë KPF-në për mbajtjen e një takimi dhe t'i shqyrtojmë kërkesat që kanë dalë nga dëgjimet buxhetore me qytetarë. Sa i përket rialokimit të mjeteve, e pushë që ka mjete që kanë tepruar nga buxheti, prandaj është mirë që të shtyhet si proces, si dhe ndoshta do të ishte e domosdoshme që të thirret një seancë e jashtëzakonshme vetëm për këtë pikë, sepse mund të ndodh që të shkojnë mjetet në suficit. Në fund pyeti se a ka shkelje të procedurave ligjore, pasi që drafti i buxhetit nuk ka ardhur para datës 1 shtator?

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – deklaroi se nuk ka shkelje ligjore, sepse me ligj kërkohet që pas aprovimit nga kuvendi të dërgohet në Ministri të Financave deri më datën 30 shtator.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së**- theksoi se sa i përket mbajtjes së një takimi të KPF-së, unë jam i gatshëm qysh të jemi dakord bashkërisht.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me shtatë (7) vota “për”, aprovoi këtë:**

#### R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 13.07.2018;
2. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018;
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2018/2019;
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore;

6.
  - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QMF-së në Vushtrri;
  - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e masës drusore të konfiskuar-institucioneve arsimore të komunës sonë;
  - c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin/ transferin e mjeteve.

Kurse, Nezir Klinaku votoi “kundër” që të procedohet në kuvend: “Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e masës drusore të konfiskuar-institucioneve arsimore të komunës sonë”.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 13.7.2018.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.***

2. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2019.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – pyeti se a janë ngritur subvencionet tek klubet sportive? A është bërë subvencionimi i bujqve sa i përket ujitjes?

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se sa i përket klubeve sportive, shumta ka mbetur e njëjtë, pasi që subvencionet në përgjithësi janë rritur vetëm për 10.000 €, kurse ne kemi kërkuar që të rriten subvencionet në 600.000 €.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se kemi kërkuar nga Ministria e Financave për rritje të subvencioneve këtë vit, mirëpo subvencionet janë rritur vetëm për 10.000 €. Ai tha se financimin në sport do ta bëjnë përmes mënyrave tjera, gjë që do ta arrijmë premtimin. Sa i përket ujitjes, Tahiri tha se do ta shpallim një tender për blerjen e ujit për ujitje nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Ai theksoi se prioritet në këtë draft-buxhet i është dhënë arsimit dhe shëndetësisë, duke u pajtuar që të mbahet një takim i KPF-së për buxhetin. Ai tha se javën tjetër do ta mbajë një takim me përfaqësues të këshillave të fshatrave dhe OJQ-ve për ta diskutuar draft-buxhetin, prandaj jeni të ftuar të merrni pjesë edhe në këtë takim, ndërkaq tha se kemi paraparë që të ofrojmë shujtë për nxënësit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – pyeti se sa i përket shujtës, a janë të përfshirë vetëm nxënësit apo edhe mësimdhënësit?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – sqaroi se varësisht nga buxheti, mirëpo fillimisht shujta do të përfshijë vetëm nxënësit.

***Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.***

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – pyeti se tek “Planifikimi urban dhe mjedisi” janë shpenzuar vetëm 2%, a mos është ndonjë gabim, apo nuk kanë filluar ende projektet që të realizohen? Lidhur

me këtë tha se nuk është performancë e mirë, përderisa janë planifikuar që të shpenzohen 1,194,143.78 €, kurse janë shpenzuar vetëm 27,527.71 €.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – sqaroi se lidhur me këtë disa projekte kanë filluar, mirëpo nuk ka përfunduar ende kontrata.

***Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.***

4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2018/2019.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – kërkoi informatë me shkrim për mbledhjen e kuvendit të komunës lidhur me konkursin e fundit në arsim. Si është zhvilluar procedura e rekrutimit të mësimdhënësve në konkursin e fundit në arsim? A janë respektuar kriteret e konkursit?

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – kërkoi informatë me shkrim se a do të vjen për mbledhjen e kuvendit “Informata për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2018/2019?

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – pyeti se a ka ndonjë masë për parandalimin e autokombajnave nga komunat tjera? A paguajnë ndonjë taksë në komunën tonë, këto autokombajna? Sepse, gjatë korrje-shirjeve po vërshojnë autokombajnat nga komunat tjera, pasi që në disa komuna korrje-shirjet fillojnë më herët.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së**- theksoi se është e vërtetë që ka autokombajna nga komunat tjera, por edhe autokombajnat e komunës tonë shkojnë në komunat tjera. Kjo çështje është problematike, sepse është treg i lirë dhe është vështirë të ndalohen autokombajnat e komunave tjera.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – deklaroi se vitin e kaluar kemi pasur një peticion nga autokombajnerët e komunës sonë, të cilët kanë kërkuar ndalimin e autokombajnave të komunave tjera. Kuvendi i komunës, vitin e kaluar e ka nxjerrë një vendim për themelimin e një komisioni nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në mënyrë që t'i kontrollojnë se: A kanë të drejtë të operojnë në komunën tonë? A i plotësojnë kushtet teknike për të operuar? Ky vendim e ka përmirësuar paksa gjendjen e autokombajnerëve të komunës sonë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – u shpreh se kjo çështje është problematike, sepse këtë vit ka pasur reshje të shpeshta të shiut. Nëse, do të kufizohej që vetëm autokombajnerët e komunës sonë të operojnë, një pjesë e madhe e bujqve nuk do të arrinin t'i kryenin korrje-shirjet dhe gruri do t'iu mbetej në arë dhe do t'i prishej. Prandaj, ligjërisht nuk kemi të drejtë t'ua ndalojmë operimin, sepse është treg i lirë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se përveç që nuk kemi të drejtë ligjërisht t'ua ndalojmë operimin autokombajnave të komunave tjera, është edhe një problem tjetër që 90% e autokombajnave janë të peregjistruara.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** – deklaroi se ajo që mund të bëjmë është të ketë një kontroll teknike që të mos humb gruri nëpër ara gjatë korrje-shirjeve.

**Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së** – tha se në mbledhjen e kaluar të KPF-së, të gjithë që ishim prezent (përveç Nezirit, i cili ka abstenuar) kemi votuar që ta procedojmë në kuvend, kurse në mbledhjen e kuvendit u krijua një situatë krejt tjetër.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

6. a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QMF-së në Vushtrri.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – tha se është një ide e qëlluar. Prandaj, vetëm desha të sugjeroja se nëse nuk ka kaluar nëpërmes zyrës ligjore, për kuvend le ta shikojë edhe njëherë zyra ligjore për formën e hartimit.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – pyeti se ndërtimi i objektit të QMF-së a është në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK)? Po ashtu pyeti drejtorin e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë se pse e ka nënshkruar kopjen e planit ai si drejtor?

**Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** - tha se ndërtimi i QMF-së është në harmoni me PZHK-në, kurse, sa i përket nënshkrimit të kopjes së planit, ai tha sistemi i ri e ka bërë një gjë të tillë. Prandaj, duhet të rregullohen disa çështje teknike në sistem dhe në të ardhmen besoj që kjo nuk do të ndodh.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – theksoi se ndërtimi i një QMF-je ka qenë e planifikuar në buxhetin e vitit të kaluar. Mirëpo, si propozim i yni ka qenë që ky objekt të ndërtohet tek shtëpia e “Mahmut agë Gjinollit”. Edhe ky propozim është një ide e qëlluar dhe ndoshta në një vend të përshtatshëm, mirëpo konsideroj që kjo pjesë e qytetit, ku kemi menduar që ta ndërtojmë, ka pasur nevojë që ta ketë një QMF.

**Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** - tha se objekti i QKMF-së që gjendet afër spitalit nuk i plotëson kriteret, sepse është ndërtuar menjëherë pas luftës. Prandaj, kemi planifikuar që këtë objekt t'ia dhurojmë spitalit që do t'i shërbejë për ambulanca specialiste, kurse, QMF 1 që gjendet afër ish-stacionit të autobusëve do të bëhet QKMF.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se ndoshta ka qenë si ide që keni menduar ta ndërtoni QMF-në tek shtëpia e “Mahmut agë Gjinollit”, mirëpo në buxhet nuk ka qenë e planifikuar. Shtëpitë ku kanë qenë tek “ambulanta e vjetër”, i kemi rrënuar dhe tërë ajo hapësirë është e destinuar për Muzeun Historik-Etnografik, kështu që kemi mungesë të hapësirave publike.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e masës drusore të konfiskuar-institucioneve arsimore të komunës sonë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – deklaroi se kjo pikë e rendit të ditës është mirë që të procedohet në kuvend. Ai pyeti se si pasuri e konfiskuar a janë të regjistruara në emër të komunës? Ai po ashtu kërkoi informatë me shkrim se çka ka ndodhur me inventarin që ka qenë në objektin e vjetër të komunës? Në çfarë formë është bërë dhurimi i tij?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – theksoi se ankandi për material ndërtimor është zhvilluar, por që nuk ka pasur të interesuar për blerjen e tij. Ligjërisht, pas përfundimit të ankandit publik, nëse nuk ka të interesuar, komuna është e lirë që të veprojë tutje.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – u shpreh se klimat, inventari, dritaret nuk kanë qenë në ankand publik. Prandaj, nëse janë shpërndarë me vendim është gjithçka në rregull.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – tha se dritaret u janë dhuruar shkollave, kurse inventari u është dhuruar shkollave, shoqatave të dala nga lufta. Ndërkaq klimat nuk u janë dhuruar askujt, pasi që një pjesë e tyre do t'i jepen Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe pjesa tjetër do të vendoset në depo (kudo që caktohet vendi). Sa i përket ngrohjeve, disa radiatorë u janë dhënë shkollave. Lidhur me këtë ka qenë i angazhuar një komision për zhvlerësim, një komision që ka marrë të dhëna për çdo gjë që është shpërndarë me vendim.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – kërkoi listën e inventarit që ka qenë në objektin e vjetër të komunës, si dhe vendimin për shpërndarjen e inventarit nga objekti i vjetër i komunës. Lidhur me këtë, ai kërkoi që të formohet një komision i KPF-së ose i kuvendit të komunës që ta verifikojë se a ka shkuar në vendin e duhur inventari. Nëse nuk ka shkuar në vendin e duhur, është vepër penale dhe do ta ndjek deri në fund këtë çështje.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – përsëri kërkoi që të mos procedohet në kuvend ky propozim-vendim. Lidhur me këtë, ai tha se juristi i drejtorisë është bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe në Statut të Komunës që nuk ka të bëjë asgjë me këtë çështje, derisa nuk bazohen fare në legjislacionin primar që është ekskluzivisht për këtë çështje si: Ligji për Pyjet e Kosovës (2003/3), Ligji Nr. 03/L-153 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2010 për Mënyrat dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drusore nga Pyjet Publike. Ai kërkoi sqarime nga zyra ligjore se thirrjet juridike a janë të qëlluara?

**Ismet Gashi, zyrtar i zyrës ligjore** – tha se në pjesën hyrëse, hartuesi nuk është thirrur në dispozitat e ligjit të veçantë. Prandaj, për kuvend mund të përmirësohet ky vendim dhe të procedohet.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – theksoi se nuk ka vepër penale që nuk parashihet me ligj. Ai tha se udhëzimi administrativ nuk është ligj. Është udhëzim që e kanë nxjerrë në drejtorinë e pyjeve dhe nuk na obligon neve si komunë dhe si kuvend, i cili shtoi se është nxjerrë në kundërshtim me Rregulloren për menaxhim të pasurisë komunale, që komuna ka të drejtë t'i jep.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – tha se kryetari po flet për hierarki të legjislacionit dhe kërkon që të zbatohet rregullorja e jo udhëzimi administrativ. Ne e dimë se cili akt e ka peshën më të madhe, prandaj më mirë merre vendimin vet.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – po flas për zbatim të Ligjit për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – kërkoj që zyra ligjore ta përmirësojë këtë propozim-vendim dhe të procedohet në kuvend.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për” dhe një (1) “kundër” (Nezir Klinaku votoi “kundër”) e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin/ transferin e mjeteve.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – sqaroi se ky propozim-vendim ka të bëjë me tri kërkesa: njëra kërkesë ka të bëjë me paga, ku kemi mungesë të pagave në tri programe, njëra kërkesë ka të bëjë me transfer të mjeteve në kuadër të programit “infrastruktura publike” dhe kërkesa tjetër ka të bëjë me shpenzime kapitale.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

**Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së** – për mbledhjen e kuvendit të komunës kërkoj informatë me shkrim për furnizim me ujë të pijshëm për qytetarët në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Kjo për shkak se siç theksoi ai kohëve të fundit ka pasur reduktime të shpeshta të ujit të pijshëm.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – nga informatat që kam, ujësjellësi në Vushtrri i ka 64 punëtorë në listë të pagave dhe asnjëri prej tyre nuk është inxhinier i hidros, as nuk është i caktuar shefi i ujësjellësit dhe nuk na jep neve llogari. Ai theksoi se gjendja në ujësjellës është kaotike, pasi që askush në ujësjellës nuk e di ku gjenden vijat e ujësjellësit dhe nuk kanë hartë të rrjetit të ujësjellësit për territorin e komunës.

**Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së** – propozoi që të silllet në kuvend propozim-vendimi që t’i vendoset emri i profesor Hajzer Krasniqit njërës nga shkollat që nuk ka emër.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se kryetari nuk mund ta caktojë drejtorin në ujësjellësin regional, sepse ata i caktojnë vetë drejtorët, sepse është kompetencë e tyre. Komuna është aksionare me një përqindje të caktuar dhe se ne mund të kërkojmë informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike. Ai pyeti se pse është ndal procesi për riemërtimin e rrugëve? Po ashtu, ai pyeti se çka ka ndodhur me një kërkesë në lagjen “Syla” Reznik për emërtim të një rruge?

**Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – deklaroi se që nga viti 2015 janë paraqitur mbi 400 kërkesa për këtë çështje, të cilat sipas tij nuk i ka marrë parasysh askush. Mirëpo, Agjencioni Kadastral i Kosovës tani na ka dërguar shkresë zyrtare, ku ka kërkuar që të mos ndryshohen emrat e rrugëve. Lidhur me emërtimin e ri të rrugëve, ai tha se

ekziston një listë e rrugëve, që pa u harxhuar të gjithë emrat në atë listë, nuk kemi të drejtë të bëjmë emërtim të ri.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – deklaroi se do ta shqyrtojmë edhe njëherë këtë rastin e lagjes “Syla” në Reznik për ta vendosur në listën rezervë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – lidhur me çështjen e mbeturinave, ai tha se ekzistojnë disa ekonomi familjare, madje ka edhe fshatra që nuk posedojnë kontejnerë për hedhjen e mbeturinave. Ai pyeti se a është bërë ndonjë planifikim se në cilat fshatra do të bëhet shpërndarja e kontejnerëve?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – theksoi se janë rreth 2000 kontejnerë, kurse kërkesat i kemi për rreth 12.000 kontejnerë. E kemi të vështirë se si t’i shpërndajmë.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** – tha se ka biseduar me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe ideja ka qenë që të bëhet shpërndarja e kontejnerëve në ato vendbanime ku si kritere të jenë: pagesa e rregullt e taksës së mbeturinave, por edhe e tatimit në pronë.

Mbledhja përfundoi në orën **15:30**.

**Bujar Klinaku**



Procesmbajtës



**Nasuf Aliu**

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së